



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

GJS-2023-002

**Ushtruesja e Detyrës së Kryetarit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës-Mejreme Memaj**, bazuar në nenin 9 par.1 nën paragrafi 1.2 dhe paragrafi 6 i Ligjit nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga B.H., për inicim të procedurës disiplinore ndaj Kryetarit të Gjykatës Themelore në Pejë dhe nënkryetares së kësaj Gjykate, më datë 28.02.2023, merr këtë:

## A K T V E N D I M

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e paraqitur nga pala B.H. ndaj Kryetarit të Gjykatës Themelore në Pejë- A.B., dhe Nënkryetares së kësaj Gjykate – N.K. – M.

## A r s y e t i m

Pala B.H., nga Peja, më 3 shkurt 2023, ka paraqitur ankesë ndaj Kryetarit dhe Nënkryetares së Gjykatës Themelore në Pejë, të cilën ankesë ia ka drejtuar autoritetit kompetentë U.D. Kryetares së Gjykatës Supreme, nëpërmes postës.

Parashtruesi i ankesës pretendon se, kryetari i gjykatës dhe nënkryetarja kanë bërë shkelje disiplinore nga neni 2 nënpar.1.1 dhe nënpar.1.3 të Ligjit nr.06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, ngase kryetari i gjykatës A.B., nuk e ka shqyrtuar ankesën e tij të paraqitur ndaj gjyqtares G.P., por, për të njëjtën ankesë me datë 4 janar 2023, ka vendosur nënkryetarja znj.N.K.M., e cila ankesë është refuzuar. Sipas ankuesit sipas nenit 14 par.1 të Ligjit për Gjykatat- kryetari i gjykatës themelore në rastin konkret gjykatës në Pejë është përgjegjës për administrimin ditor të gjykatës në përputhej me rregullat dhe procedurat e përcaktuara nga Këshilli. Kurse, sipas par.4 të të njëjtit nen-nënkryetarja e gjykatës ushtron detyrat e kryetarit të gjykatës në mungesë të tij, apo kur kryetari e ka të pamundshëm ushtrimin e detyrave të tij. Nënkryetari ushtron detyra të tjera të cilat delegohen me shkrim nga kryetari

i Gjykatës. Në rastin konkret nuk ka asnjë provë apo fakt me të cilin do të zbatohet dispozita ligjore neni 14 par. 4 të ligjit për gjykata, sipas të cilit nënkryetarja do të ushtronte detyrën e kryetarit të gjykatës, për më tepër nuk ka asnjë provë që do ta mbulonte faktin se kryetari i gjykatës ka munguar apo e ka të pamundur ushtrimin e detyrave të tij si kryetar, apo se nënkryetares i janë deleguar me shkrim kompetencat e ushtrimit të detyrës nga kryetari. Me tej, ankuesi pretendon se nënkryetaren e gjykatës e ka pas shoqe të klasës në shkollën fillore, e të cilin fakt ajo e ka fshehtë. Kurse, kryetari B., gjatë ushtrimit të funksionit publik të tij nuk ka vepruar në mbrojtje të interesit publik në atë mënyrë që interesin e tij privat e ka venë para atij publik. Ankuesi ka kërkuar që përveç hetimit të shkeljes disiplinore çështja të dërgohet tek organet e prokurorisë kompetente sepse konsideron se në veprimet kryetarit dhe nënkryetares qëndrojnë elementet e veprës penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare dhe ushtrimit të ndikimit. Kërkesës ia ka bashkëngjitur ankesën e ushtruar ndaj gjyqtarës G.P., aktvendimin e marrë nga kjo gjyqtare me numër C.nr.42/2020 datë 13.10.2022 dhe aktvendimin e nënkryetares lidhur me ankesën e tij AD/GJTHPE.nr.14/2022 datë 4.01.2023.

Meqenëse ankuesi përveç pretendimeve për shkelje disiplinore konsideron se këto veprime konsumojnë edhe vepër penale si autoritet kompetent fillimisht kam shqyrtuar ankesën në këtë drejtim dhe pas shqyrtimit të bazës faktike dhe juridike të shkeljes së supozuar disiplinore në drejtim të elementeve të veprës penale vlerësoj se shkelja e supozuar disiplinore nuk përmban elemente të veprës penale, prandaj çështjen nuk e kam referuar tek prokurori i shtetit por kam filluar shqyrtimin për shkeljet e pretenduara disiplinore.

Me qëllim të vërtetimit të bazës së arsyeshme siç kërkohet me ligj të pretendimeve sa i përket shkeljeve disiplinore si autoritet kompetent kam kërkuar nga kryetari dhe nënkryetarja e gjykatës të deklarohen lidhur me këtë rast dhe kam pranuar deklaratat e të njëjtëve.

Në deklaratën e tij kryetari, A.B., thekson se arsytet mbi të cilat është mbështetur ankesa disiplinore e parashtruar ndaj tij nuk përbën shkelje të natyrës disiplinore sipas nenit 5 par. 1 dhe 2 të Ligjit për Përgjegjësi Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve ashtu siç pretendon ankuesi. Gjyqtarja N.K.M. me vendim të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, është caktuar nënkryetare e gjykatës themelore në Pejë, ndërsa, me Planin Vjetor të Punës së Gjykatës Themelore në Pejë është përcaktuar se "Nënkryetare e Gjykatës Themelore në Pejë është gjyqtarja N.K.M., e cila do të ndihmojë në menaxhimin e punës së gjykatës dhe në mungesë të kryetarit shërben si ushtruese e detyrës së kryetarit të gjykatës", njëjloj siç është rregulluar edhe me nenin 14 par.4 të Ligjit për Gjykata dhe nenin 6 të Rregullores 07/21 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Gjykatën Themelore dhe Degët e saj. Kurse, pretendimet tjerat se në bashkëkryerje me nënkryetaren ka keqpërdorur detyrën zyrtare, janë tërësisht joserioze dhe të pabazuara. Në mënyrë të njëjtë deklaroi edhe nënkryetarja e gjykatës N.M. duke shtuar se qëndron fakti se ankuesin e ka pas katër vite shok të shkollës fillore të cilën e ka përfunduar në vitin 1974, pra, dyzet vite më parë dhe që nga ajo kohë asnjëherë nuk është takuar me të.

Pas analizimit të pretendimeve të ofruara nga parashtruesi i ankesës, provave të cilat ja ka bashkëngjitur ankesës së tij, deklaratës së kryetarit dhe nënkryetares së Gjykatës Themelore në

Pejë, vlerësojë se në rastin konkret nuk ka vend për të hapur procedurë disiplinore për këto arsye:

Si autoritet kompetent, se pari vlerësoj se par.2 nënpar.1.1 e 1.3 i Ligjit për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve nuk i referohet shkeljeve disiplinore por përkufizimeve se çka nënkupton Autoritet kompetent, Këshill, Kryetar i Gjykatës, Kryeprokuror dhe vepër e rendë penale.

Së dyti, vetëm nga fakti se kryetari i gjykatës nuk e ka shqyrtuar ankesën e ( ankuesit në rastin konkret) e tij të ushtruar ndaj gjyqtarës G.P., por këtë ankesë e ka shqyrtuar nënkryetarja edhe pse kryetari nuk ka munguar apo nuk e ka pas të pamundur ushtrimin e detyrave të tij si kryetar, nuk mund të aludohet se ata kryer shkelje disiplinore.

Është evidente se sipas dispozitës së nenit 14 par.4 të Ligjit për gjykatat “nënkryetari i gjykatës ushtron detyrat e kryetarit të gjykatës në mungesë të tij, apo kur kryetari e ka të pamundshëm ushtrimin e detyrave të tij. Nënkryetari ushtron detyra të tjera të cilat i delegon me shkrim nga kryetari i gjykatës”. Por, kjo dispozitë nuk nënkupton se vetëm në këto raste nënkryetarja ushtron detyrat e kryetarit të gjykatës. Në fakt përveç këtyre rasteve kjo nuk nënkupton se nënkryetarja e gjykatës nuk mund ta ndihmojë kryetarin e gjykatës në ushtrimin e detyrave të tij duke pasur parasysh vëllimin e punës dhe përgjegjësitë e tij.

Nga arsyet e cekura, e në bazë të nenit 9 par. 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, dhe nenit 7 par.3 nënpar. 3.2 të Rregullores së KGJK-së, nr.05/2019, për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Mejreme Memaj  
U.D. Kryetare e Gjykatës Supreme

Kopje:

1. Këshilli Gjyqësor i Kosovës,
2. Kryetarit të Gjykatës Themelore në Pejë,
3. Nënkryetares së Gjykatës Themelore në Pejë
4. Parashtruesit të ankesës
5. Arkivit të Gjykatës Supreme.